



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 15.07.2016

Ref.: 650/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 43-të, të mbajtur më 06 Korrik 2016, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet BPrAL Kolegji “Universi” në nivel institucional për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019.
- II. Riakreditohen programet e studimit për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:
 - Infermieri e Përgjithshme, BSc, 180 ECTS, (maksimum 50 student për vit akademik);
 - Kulturë Fizike, Sport dhe Rekreacion, BSc, 180 ECTS, (maksimum 80 student për vit akademik).
- III. Nuk akreditohet programi i studimit:
 - Infermieri, MSc, 120 ECTS.
- IV. Kuotat e caktuar më sipër për regjistrim e studentëve në programet e studimit, vlejné nga viti akademik 2017/2018.
- V. Obligohet BPrAL Kolegji “Universi” që deri me 1 tetor 2016 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2016/2017, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.

VI. Obligohet BPrAL Kolegji “Universi” që deri më datë 1 tetor 2016 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.

A r s y e t i m i

BPrAL Kolegji “Universi” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për riakreditim institucional dhe ri/akreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Infermieri e Përgjithshme	BSc	180	Kadri Huseyin, Sejran Abdushi, Behrije Halilaj (përfshirë marrëveshjen e bashkëpunimit me një universitet ndërkombëtarë)
2	Kulturë Fizike, Sport dhe Rekreacion	BSc	180	Avdi Pireva, Abedin Bahtiri, Sylejman Shala
3	Infermieri	MSc	120	Fadil Kryeziu, Nijazi Gashi, Feim Mazreku (përfshirë marrëveshjen e bashkëpunimit me një universitet ndërkombëtarë)

AKA ka organizuar vizitën në BPrAL Kolegji “Universi” më 06.06.2016 me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Danica Zeleznik; Prof. Dr. Dusan Hamar; Prof. Stephen Adam; dhe Ms. Elena Rusnak. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 06 Korrik 2016 ka vlerësuar aplikacionin e BPrAL Kolegji “Universi”, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me programin e studimit Infermieri, MSc, 120 ECTS, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë quar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Vizioni dhe deklarata e misionit të institucionit nuk reflekton filozofinë e Infermierisë. Sipas ekspertëve programi i studimit Master në Infermieri është tepër i orientuar drejt fushës mjekësore dhe duhet të rishikohet në mënyrë që të përfshijë filozofinë e të gjitha njësive mësimore të cilat lidhen me infermierinë. Standardet akademike sipas ekspertëve

janë të larta mirëpo nuk reflektojnë direktivën dhe standardet e BE-së për Infermieri. Ekspertët kanë mësuar se të tri specializimet e paraqitura nga institucioni ligjërohen nga mjekë, gjë që nuk është e përshtatshme. Në gjithë programin e studimit vetëm njëri nga ligjëruesit është PhD kandidat, gjë që po ashtu nuk është e përshtatshme. Duke pasur parasysh se qëllimi dhe direktiva e BE-së për programet në Infermieri për sa i përket stafit akademik nuk është përmbushur, dhe se menaxhmenti i institucionit nuk ka arritur që të paraqes një plan zhvillimor i cili do të tregonte zhvillimet dhe përmirësimet të cilat do të mund të bëhen viteve në vazhdim, ekspertët nuk kanë qenë në gjendje që të japin rekomandim për akreditim.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "Universi"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

Prof Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë